



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 240, Datë 22.09.2022

MBI

NJË NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 194, DATË 21.07.2022 MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GREEN ENERGY BILISHT” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “ME VENDODHJE NË ZONËN BITINCKË, BILISHT, QARKU KORÇË ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, PËR NJË AFAT 25 VJEÇAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.09.2022 mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1539/7 prot., datë 20.09.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshime në vendimin nr. 194, datë 21.07.2022 mbi licencimin e shoqërisë “Green Energy Bilisht” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendodhje në zonën Bitinckë, Bilisht, qarku Korçë me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25 vjeçar”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 194, datë 21.07.2022, vendosi të licencojë shoqërinë “Green Energy Bilisht” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Në pikën 3 të dispozitivit të këtij vendimi përcaktohet se: *3. Shoqëria “GREEN ENERGY BILISHT” sh.p.k. të depozitohet në ERE brenda 30 ditëve pune nga marrja dijani, dokumentacion për mbulimin e pjesës së mbetur të investimit për ndërtimin e centralit fotovoltaik.”.*
- Me shkresën nr. 448/6 prot., datë 27.07.2022, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimarrje, duke i kujtuar detyrimin për të plotësuar kushtin sikurse përcaktuar në vendimin nr. 194/2022.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 448/8, datë 13.09.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar, duke plotësuar kështu kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit të sipërcituar.

- Me plotësimin e kushtit, pika 3 e vendimit nr. 194/2022 shfuqizohet.
- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi të ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë pikën 3 të vendimit nr. 194, datë 21.07.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “Green Energy Bilisht” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me vendodhje në zonën Bitinckë, Bilisht, qarku Korçë me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25 vjeçar”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI